



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1019/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci, anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Lindita Misini nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Viti paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1019/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Lindita Misini nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Viti ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit: QV 2604d, QV 2605d, QV 2612d, QV 2613d, QV 2625d, QV 2063d, QV 2607d, QV 2607d, QV 2608d, QV 2617d, QV 2609d, QV 2611d, QV 2621d, QV 2623d, QV 2627d, QV 2630d dhe QV 2632d në Komunën e Vitisë.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Lindita Misini nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Viti, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit: QV 2604d, QV 2605d, QV 2612d, QV 2613d, QV 2625d, QV 2063d, QV 2607d, QV 2607d, QV 2608d, QV 2617d, QV 2609d, QV 2611d, QV 2621d, QV 2623d, QV 2627d, QV 2630d dhe QV 2632d, për shkak se në këto qendra të votimit i mungojnë votat e të afërmeve/familjareve, nuk i figurojnë votat.

Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e 6 votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton kandidatja për për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Lindita Misini nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në

Viti ka paraqitur apel ku ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit: QV 2604d, QV 2605d, QV 2612d, QV 2613d, QV 2625d, QV 2063d, QV 2607d, QV 2607d, QV 2608d, QV 2617d, QV 2609d, QV 2611d, QV 2621d, QV 2623d, QV 2627d, QV 2630d dhe QV 2632d.

Paneli, vlerëson se parashtresja i apelit në mbështetje të pretendimeve të saj nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankueses se deklaratat e dorëzuar për QV-të e vendosura si në dispozitiv të këtij vendimi janë dëshmimi se ka pasur vota në ato QV, poashtu për paneli është e qartë se në këto QV kandidatja në fjalë ka pas vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesja në QV e vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi nuk i'ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatit përfundimtar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr.1019/2021 më datën 07.11.2021**



**Kryesuese të Panelit  
Kymete Kicaj**

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.